



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee
DPSDPLS.nr.13/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, [REDACTED], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], duke vendosur lidhur më ankesën e paraqitur nga "[REDACTED]" me seli në [REDACTED] lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore P.nr.415/24, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahija Kërveshi, pala ankuese i përfaqësuar nga [REDACTED], personalisht Përmbaruesi Privat, me datën 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET ankesa e paraqitur nga pala ankuese, "[REDACTED]" me seli në [REDACTED], si e pa bazuar.

II. Përmbaruesi Privat [REDACTED] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED], **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.415/24.

A r s y e t i m

Pretendimet e inicuesit të Procedurës disiplinore.

Me datën 01.07.2025, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbaruesit Privat, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore, me të cilën pretendon

se përmbaruesi privat pas inkasimit të borxhit kryesor me dt.15.05.2024 ka vazhduar me tërheqje të shumes tjetër në tejkalim të vet propozimit për përmbarim me një diferencë fillimisht 1,839,988.05 euro dhe se [redacted] duke qenë se nuk kishte njohuri mbi këtë shume kishte kërkuar sqarime nga përmbaruesi dhe se një dite pas kësaj përmbaruesi ka lajmëruar palën ankuese se kishte caktuar ekspert financiar për llogaritjen përkatëse dhe se shuma e tërhequr përtej propozimit kishte të bënte me kamatën. Me të pranuar ekspertizën pala ankuese ka dhënë vërejtje dh kundërshtime ani pse një e drejt e tillë nuk i është dhënë palës ankuese. Tutje pala ankuese pretendon se përmbaruesi në vend të një reagimi procedural pa dhen asnjë përgjigje kishte vazhduar tërheqjen nga llogaria e [redacted] 16,159,334.16 euro, ku kjo çështje është ngritur edhe ne Gjykatë ku me aktvendim KPP.nr.500/25 Gjykata Komerciale kishte gjykuar se ka pas parregullsi në procedure si dhe ka detyruar përmbaruesin të kthej shumen prej 4,483,954.30 euro, pastaj kjo çështje është kthyer në rigjykim ndërsa këtë vendim pala ankuese nuk e ka pranuar asnjëherë. Në rigjykim i njëjti gjyqtar në kundërshtim me rekomandimet e dhëna nga shkalla ma e lartë nuk ka vepruar që të konstatoi drejt gjendjen faktike me çka pala ankuese [redacted] ka paraqitur ankese dhe se e njëjta ende nuk është shqyrtuar. Në fund ka shtuar se nga elaborimi i lartcekur vërehet se përmbaruesi privat me mos dhënien e mundësisë për deklaram palës rreth ekspertizës, përlllogaritjes së kamatës ka kryer shkelje për të cilat janë specifikuar ne nenin 367 të LPP-së paragrafi 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.10. Lidhur me pjesën se duhet dhënë mundësia e deklaramit palës rreth detyrave të ekspertizave specifikohen në nenin 354 të LPK-së . I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbaruesi privat.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë dhe mbetet në tërësi pran raportit të saj të prezantuar në seancën e datës 30.09.2025.

Pretendimet e Përmbaruesit Privat, palë në këtë procedurë

Përmbaruesi Privat, si në përgjigjen e inicimit të procedurës disiplinore, ashtu edhe në seancë dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi ankesën për iniciimin e procedurës disiplinore, pasi kjo procedurë fillimisht është derivat i vendimit i Gjykatës së shkalës së parë i cili vendim është anuluar dhe se në rivendosje është konstatuar se nuk ka pasur parregullsi në kryerjen e veprimeve përmbarimore. Ka shtuar se në procedurë civile kemi të bëjmë me gjyqëvarsi dhe se shtrohet pyetja nëse Gjykata Komerciale e Kosovës ka refuzuar

ankesën për parregullsi logjistikisht nuk mund të ketë edhe shkelje disiplinore, përndryshe kjo çështje është iniciuar komform dokumentit përmbartimor vendimit të arbitrazhit i rregulluar me nenin 22 të LPP-së dhe se kamata është përlogaritur komform datave të gjykuara të vendimeve të lartcekura dhe se janë shterur të gjitha mjetet juridike si në vendosje për prapsim si në vendosje në ankesë, si në vendosje për kërkesën për përjashtim të përmbartuesit si dhe së fundi është refuzuar ankesa për parregullsi. Në fund i ka propozuar Komisionit që të njëjtin ta shpall jo përgjegjës për këtë çështje.

Baza ligjore që një përmbartues privat mund të bëjë shkelje disiplinore

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbartimore, i përcakton shkeljet përmbartimore për përmbartuesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbartuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbartuesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbartuesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbartuesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerr;
- 1.5. Nëse përmbartuesi privat ndërmerr veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbartuesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;
- 1.7. Nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbartuesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbartimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbartuesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Vlerësimi përfundimtar i Komisionit Disiplinor për Përmbartues Privat

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lart cituar, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që

pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Nuk është kontestuese se përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues – vendimit përmbartues i dhënë në procedurë të arbitrazhit, po ashtu nuk është kontestuese se pas lejimit të urdhrit i njëjti është atakuar me prapësim dhe ankesë të debitorit këtu palës ankuese dhe se prapësimi dhe ankesa e palës ankuese ishin refuzuar. Po ashtu pasi urdhri përmbartimor është bere i formës së prerë është caktuar ekspertizë financiar për përlllogaritjen e kamatës dhe pas saj janë tërhequr mjetet financiar ashtu si janë llogaritur nga eksperti financiar përshirë kamatëvonesën. Po ashtu nuk është kontestuese se pala ankuese për mënyrën e llogaritjes së kamatës dhe caktimin e ekspertit financiar kishte paraqitur ankesë për parregullsi në Gjykatën Komerciale, Dhoma e Shkalles së Parë e cila fillimisht kishte konstatuar se kishte pasur parregullsi mirëpo pasi çështje është kthyer në rigjykim dhe rivendosje nga Dhoma e Shkalles së Dytë e kësaj Gjykate, tani është refuzuar ankesa e debitorit këtu palës ankuese lidhur me parregullsinë e pretenduar sa i përket çështjes së caktimit të ekspertizës financiare dhe llogaritjes së kamatëvonesë.

Kontestuese mbetet në këtë rast, se a kemi të bëjmë me shkelje disiplinore, pasi sipas pretendimeve të debitorit-palës ankuese, përmbartuesi privat nuk iu ka përmbajtur dispozitave ligjore rreth caktimit të ekspertit financiar për llogaritjen e kamatëvonesës duke ja pamundësuar deklaramit të palës rreth detyrave të ekspertizave.

Komisioni Disiplinor vlerëson se në rastin konkret, pas analizimit të dispozitës së lartcekur ligjore, ndarjen e çështjeve jo kontestuese dhe atyre kontestuese si më lart, kemi të bëjmë ekskluzivisht me vlerësimin e parregullsive rreth caktimit të ekspertizës financiare nga përmbartuesi privat lëndor. Në këtë rast nuk është në kompetencën e komisionit disiplinor, që të vlerësoi parregullsinë rreth caktimit të ekspertizës financiare të përmbartuesit privat, sepse siç dihet dhe siç është e përcaktuar me LPP, ligjshmëria e caktimit të ekspertizës nga përmbartuesi privat, i nënshtrohet ligjshmërisë sipas ankesës kundër parregullsive me rastin e kryerjes së përmbartimit, siç përcaktohet me dispozitën e nenit 79, paragrafi 1, i LPP-së. Andaj, komisioni në këtë procedurë e ka vlerësuar vetëm çështjen e kërkesës për çështje disiplinore, që për komisionin përmbartuesi nuk është përgjegjës, ngase nuk është lëshuar në ekzaminimin e kërkesës së inicuesit të kësaj procedure, meqë rasti ka të bëjë me shkeljen eventuale të parregullsisë rreth caktimit të ekspertizës financiare (e cila në rastin konkret tashme është në

procedurë e sipër në Gjykatën Komerciale të Kosovës), e që nuk është në juridiksionin e këtij komisioni që ta vlerëson ligjshmërinë e vendimit të përmbaruesit, ashtu siç u vlerësua më lart. Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPSDPLS.nr.13/2025 datë 30.09.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor

Naim Meholli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.